



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:058702

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05753403

KPPP.nr.2221/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës SH.A., me seli në Prishtinë, sheshi "Nënë Tereza", nr.36, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve "Siguria", me seli në Prishtinë, Rruga "Qamil Hoxha", nr.51, të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "Arbëresh" SH.P.K., duke vendosur lidhur me ankesën ndaj parregullsive me rastin e kryerjes së përmbartimit të datës 17.11.2023, në lëndën sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.215/23 të datës 15.08.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Isak Islami, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si e pabazuar ankesa e debitorit Kompania e Sigurimeve "Siguria", me të cilën ka kërkuar anulimin e veprimeve të ndërmarra nga përmbartuesi privat Isak Islami në çështjen përmbartimore P.nr.215/23 të datës 15.08.2023.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.215/23 të datës 15.08.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të në bazë të titullit ekzekutiv Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.288/20 të datës 02.04.2021, për shumën e detyrimit prej 399,068.57 €.

Kundër këtij urdhri përmbartimor me datë 18.08.2023, debitori ka paraqitur prapësim, ndërsa kjo gjykatë me Aktvendimi KPPP.nr.1322/23 të datës 27.09.2023, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit.

Debitori me datë 17.11.2023, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë lidhur me parregullsitë e përmbartuesit privat në këtë çështje përmbartimore, duke theksuar ndër të tjerash se i njëjti në mënyrën se si i ka kryer detyrat e tij si përmbartues ka kryer parregullsi, debitori ka venë re mungesën e disa veprimeve thelbësore që duhet të merren nga përmbartuesi privat, përkatësisht ka theksuar se kanë munguar vultat të cilat duhej të kryheshin dhe të dokumentoheshin nga ana e përmbartuesit privat për të siguruar një proces të drejtë dhe konkret në këtë rast. Mungesa e këtyre veprimeve thelbësore ka sjellë parregullsi gjatë kryerjes së procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi Privat me datë 21.05.2024 ka dhënë përgjigje ndaj ankesës së debitorit për parregullsi në këtë procedurë përmbartimore, duke theksuar se përmbartuesi privat në përpikëri i ka respektuar dispozitat e ligjit të procedurës përmbartimore, dhe se debitori ka për qëllim vetëm zvarritjen e procedurës përmbartimore.

Gjykata, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës së debitorit për parregullsi në kryerjen e përmbartimit, si dhe kundërshtimeve të përmbartuesit privat të dhënë në përgjigjen ndaj ankesës, duke u bazuar në nenin 79 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (tutje si LPP) gjeti se e njëjta është e pabazuar për arsyet si në vijim:

Me dispozitat e nenit 79 të LPP-së përcaktohet se *“Pala ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë mund të parashtrorjë një ankesë në Gjykatë, lidhur me parregullsitë që janë kryer nga organi përmbartues gjatë kryerjes së procedurës së përmbartimit. Kjo kërkesë i bëhet Gjykatës me një parashtrësë me shkrim në afat prej shtatë (7) ditësh nda dita e ndodhjes së parregullsisë së pretenduar”*.

Me dispozitat e nenit 191 të LPP-së përcaktohet se *“Për të vendosur për propozimin për përmbartimin për sendet e paluajtshme dhe për zbatimin e aktvendimit për përmbartimin, përmbartuesi privat ka kompetencë për të vendosur mbi propozimin përmbartimor dhe të zbatojë përmbartimin”*, ndërsa, dispozita e nenit 204 paragrafi 1 parasheh se *“Pas dhënies së aktvendimit*

për përmbarrimin ose urdhrit për përmbarrim, organi përmbarrues sipas detyrës zyrtare e urdhëron shënimin e përmbarrimit në librin publik të paluajtshmërive”.

Në kuptim të dispozitave të lartcekura dhe duke marrë për bazë shkresat e lëndës, Gjykata gjen se Përmbarruesi Privat konform dispozitave të nenit 191 si dhe nenit 204 paragrafi 1 të LPP-së, ka ndërmarrë të gjitha veprimet përmbarrimore në mënyrë të drejtë të cilat nuk parashohin ndonjë parregullsi me rastin e kryerjes së përmbarrimit.

Gjykata vlerësoj edhe pretendimet e debitorit se me rastin e kryerjes së përmbarrimit kanë munguar vultat të cilat duhej të kryheshin dhe të dokumentoheshin nga ana e përmbarruesit privat për të siguruar një proces të drejtë, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk qëndrojnë nga shkresat e lëndës rezulton se çdo veprim i cili është ndërmarr nga ana e përmbarruesit privat, përmban vulën përkatëse.

Nga të lartcekurat, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Përmbarruesi Privat nuk ka ndërmarrë veprime të cilat konsistojnë në parregullsi me rastin e kryerjes së përmbarrimit, andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin nenit 79 par.1 në lidhje me par.3 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2221/23, datë 29.05.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.